

UDHËZIM
Nr. 3, datë 7.1.2021

**PËR MËNYRËN E DIGJITALIZIMIT, ADMINISTRIMIT, RUAJTJES DHE
DORËZIMIT TË ARKIVIT NË FORMAT DIGJITAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 142, pika 11, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

UDHËZOJ:

1. Arkivat noterialë administrohen në formatin fizik (*hard copy*) dhe në formatin digjital.
 2. Noterët përfundojnë digjitalizimin në tërësi të arkivave noterialë të tyre, brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.
 3. Noterët kryejnë digjitalizimin e të gjitha dokumenteve noteriale, duke nisur që nga dokumenti noterial i parë i kryer, që nga momenti i dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, deri në momentin e fillimit të punës me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 4. Noteri nuk ka detyrim të digjitalizojë dokumentet noteriale, të cilat janë asgjësuar nga ai për shkak të kalimit të afatit ligjor, sipas përcaktimeve nënligjore në fuqi në ditën e regjistrimit të tyre, por ruan dhe skanon procesverbalin përkatës.
 5. Digjitalizimi i arkivit noterial nga noterët kryhet nëpërmjet skanimit dhe ngarkimit në sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare, të dokumenteve noteriale, që kanë në arkivin noterial dhe që nuk janë asgjësuar për shkak të kalimit të afatit ligjor, sipas përcaktimeve nënligjore në fuqi në ditën e regjistrimit të tyre.
 6. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim në kohë reale në sistemin elektronik të Regjistrimit Noterial Shqiptar të gjitha dokumentet noteriale që regjistrohen në të, si rrjedhojë e digjitalizimit të arkivave noterialë.
 7. Noteri kujdeset për ruajtjen në formatin digjital të arkivit noterial dhe mban përgjegjësi për çdo dëmtim të tij.
 8. Dokumentet e arkivit të noterit, në format digjital, shfrytëzohen e administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga vetë noteri, personat e parashikuar me ligj ose personat e autorizuar nga noteri dhe nën mbikëqyrjen e tij.
 9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët.
 10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)